

PUBLIC INTERNATIONAL BUSINESS COLLEGE MITROVICA

Bislim Bajgora, 40000, Mitrovica, Kosovo

www.ibcmmitrovica.eu phone: 028 516 800



Në bazë të nenit 8 të Statutit të Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovicë (IBCM), si dhe vendimin e Këshilli Drejtues i Kolegjit Publik Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë në takimin e mbajtur më datë 11.04.2025, shpall:

KONKURS

Për punë praktike me pagesë për studentët e Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovicë (IBCM)

Ftohen studentët dhe ata të diplomuar në Kolegjin Publik Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovicë (IBCM) të aplikojnë për punë praktike në administratën e Kolegjit IBCM. Këta praktikanta do të mbështesin departamentin e marketingut dhe do të përfshihen në aktivitetet në marketing sbashku me stafin administrativ në dy kampuset e IBCM dhe në kampanjën e rekrutimit për vitin 2025 si më poshtë:

Gjithësej janë 6 praktikanta nga drejtimet shitje ndërkombëtare dhe marketing, Administrarë publike dhe mirëqenie si dhe menaxhimi i mjedisit dhe agrokulturës.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e studimeve dhe diplomuarit në IBCM.

Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike:

Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike do të merret parasysh nora mesatare gjatë studimeve bachelor dhe master, njohja e gjuhës angleze, njohja e përdorimit të teknologjisë informative dhe aktivitetit në shërbim të komunitetit studentor e akademik. Gjithashtu vlerësimi i tyre do të bëhet edhe gjatë fazës së intervistës.

Kohëzgjatja e punës praktike është gjashtë (6) muaj.

Dokumentacion i nevojshëm për aplikim dhe mënyra e aplikimit

1. Kopjen e letërnjoftimit;
2. CV dhe letrën motivuese
3. Kopjen e diplomës (për të diplomuarit) ose çertifikatën e notave (për studentët)
4. Çertifikatën penale

Data për aplikim është nga data 15.04.2025 deri me 22.04.2025, në ora 16:00.

Për kohën e intervistës, studentët do të njoftohen me kohë përmes e-mailit.

Shpallja e listës me kandidatët e përzgjedhur nga Komisioni ad hoc do të bëhet me datë 25.04.2025.

Studentët e përzgjedhur për punë praktike, do të nënshkruajnë kontratën e angazhimit me Kolegjin.

Dokumente duhet dorëzohen në formatin elektronik pdf në e-mailin adresen: ibcm_vacancy@ibcmmitrovica.eu.

Studentët do të angazhohen me orar të plotë (08:00-16:00)

Kandidatët që nuk pranohen kanë të drejtë ankese në afat prej 3 ditësh në Komisionin për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve, në kuadër të Kolegjit.

Inkurajojmë që të aplikojnë të gjithë studentët e Kolegjit pa kurrfarë dallimi, të gjithë ata që i plotësojnë kriteret e konkursit. Praktikantët në përfundim të punës praktike, do të pajisen me certifikatë nga Kolegji i IBCM.

